

EKSPLORIMI MIDIS AFTËSIVE RREGULLATIVE DHE NDËRPERSONALE TEK
NXËNËSIT QË KANË PËRJETUAR VIKTIMIZIM TË SHUMËFISHT NË SHKOLLAT E
KOMUNËS SË PRISHTINËS

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË DEPARTAMENTIN E PSIKOLOGJISË

NGA

DONIKA HALITI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

PRISHTINË

SHKURT, 2022

Eksplorimi midis aftësive rregullative dhe ndërpersonale tek nxënësit që kanë përjetuar
viktimizim të shumëfisht në shkollat e komunës së Prishtinës

Tema e prezantuar nga :

Donika Haliti

Mentori:

Dr. Ass. Prof. Kaltrina Kelmendi

Kapitulli I

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojmë marrëdhënien midis aftësive rregullative dhe ndërpersonale tek nxënësit që kanë përjetuar viktimizim të shumëfishtë, dhe nëse egzistojnë dallime gjinore tek këta nxënës.

Pyetjet hulumtuese/Hipotezat

Kështu, duke i'u referuar literaturës dhe studimeve të shumta parashtrijmë dy pyetje kërkimore për këtë hulumtim:

1. *A ekzistonë lidhshmëri mes aftësive rregullative dhe ndërpersonale me viktimizimin e shumëfishtë?*
2. *A ka dallime gjinore në viktimizimin e shumëfishtë?*

Hipotezat:

H1: Ekzistonë lidhshmëri negative mes aftësive rregullative dhe viktimizimit të shumëfishtë.

H2: Ekzistonë lidhshmëri negative mes aftësive ndërpersonale dhe viktimizimit të shumëfishtë.

H3: Vajzat kanë nivel më të lartë të viktimizimit të shumëfishtë sesa djemët.

Rëndësia dhe origjinaliteti i temës

Përkundër studimeve të kryera në vendët e tjera, në vendin tonë nuk ekzistojnë studime të publikuara të cilat na ofrojnë të dhëna ku do të mund të referoheshim. Mungesa e hulumtimeve të këtij fenomeni te ne, nuk do të thotë që ky fenomen nuk ekziston apo nuk shfaqet edhe në familjet dhe shkollat tona. Në një shoqëri të sapo dalur nga lufta, ku viktimizimi i shumëfishtë ka qenë pjesë e përditshmërisë ndaj secilit prej nesh, është e dukshme që ende nuk kemi gjetur një rrugëdalje më të shpejtë nga kjo situatë. Ku ne si shoqëri nuk e kemi të qartë se çka është një masë disiplinore dhe dhunë ndaj nxënësit/fëmijës,. Sa i përket rasteve të abuzimit seksual, në një shoqëri tradicionale si e jona, ku qështjet që përfshijnë anën seksuale duhet të mbahen të fshehura sepse trajton nderin e familjes ekzistojnë edhe tani, për këtë arsye rastet e publikimit janë në një nivel shumë të ultë. Andaj, një studim i tillë është tejet i rëndësishëm për shoqërinë tonë kosovare, që të studiojnë marrëdhëniet poli-viktimizim / reziliencia, dhe gjithashtu të hartojnë ndërhyrje dhe programe parandaluese të cilat përfshijnë burimet më të rëndësishme të reziliencës.

Në këtë kapitull janë përfshirë: koniza teorike, shqyrtimi i literatës, konteksti Kosovar dhe rëndësia e studimit, dhe pyetjet hulumtuese/hipotezat.

Kapitulli II

Në këtë kapitull përfshihet Metodologjia, pjesëmarrësit, procedura, dizajni, instrumenti, dhe konsiderata etike.

Sa i përket metodave të hulumtimit, gjatë këtij studimi është përdorur metoda sasimore pasiqë instrumenti i caktuar për mbledhjen e të dhënave është pyetësori. Hulumtimi është realizuar në Prishtinë, ku pjesëmarrës kanë qenë nxënësit e moshave 14-16 vjeç, gjithsej 104 respondent, 50 Meshkuj dhe 54 Femra.

Ndërsa pjesa e analizave statistikore e të dhënave është bërë me programin e SPSS-it, përmes së cilit për të matur lidhshmërinë ndërmjet aftësive rregullative dhe ndërpersonale kemi përdorur korrelacionin, ndërsa për dallimet gjinore është përdorur t-testi.

Pyetësi i cili është përdorë në këtë studim;

Pyetësi për Viktimizimin e të Miturve (JVQ) (Finkelhor et al., 2005) dhe Modelin e Portofolios të Reziliencës (Hamby et al., 2018).

Kapitulli III

Në këtë seksion u shtjelluan rezultatet e punimit. Analiza e korelacionit të Personit është përdorur për të vërtetuar nëse ka lidhshmëri mes aftësive rregullative të cilat përfshijnë *Menaxhimi i Zemërimit*, *Ndërgjegjësimi Emocional*, *Rregullimi Emocional* dhe *Qëndrueshmërinë* me viktimizimin e shumëfishtë, dhe rezultatet konfirmuan një lidhje të rëndësishme në nivelin 0.05 mes rregullimit emocional dhe viktimizimit të shumëfishtë ($r = .237^*$, $p = .343$), ndërsa menaxhimi i zemërimit ishte ($r = -.067$, $p = .498$), ndërgjegjësimi emocional ($r = -.094$, $p = .343$) dhe qëndrueshmëria ($r = -.180$, $p = .068$), nuk treguan që ka lidhshmëri të rëndësishme me viktimizimin e shumëfishtë. Poashtu, rezultatet e fituara që na treguan se Aftësitë Rregullative kanë një lidhje të rëndësishme me Mirëqenien Subjektive ($r = .384^*$, $p = .000$). Mirëpo, një gjë e tillë nuk ndodhi ndërmjet Aftësive Rregullative dhe Viktimizimit të shumëfishtë, ku rezultatet treguan korrelacion negativ jo të rëndësishëm ($r = -0.092$, $p = 0.352$).

Ndërsa mes aftësive ndërpersonale dhe *Mbështetjen Sociale* dhe viktimizimin e shumëfishtë, rezultatet treguan se nuk ka lidhje të rëndësishme mes tyre ($r = -.025$, $p = .804$). Mirëpo, rezultatet na treguan se ekziston një lidhje të rëndësishme ndërmjet Mirëqenies Subjektive dhe Aftësive Ndërpersonale ($r = .589$, $p = .000$).

Përmes Independent Samples t-test kemi analizuar gjininë në raport me viktimizimin e shumëfishtë, dhe rezultatet kanë dalë se nuk ka dallime të rëndësishme mes grupit të vajzave ($M = 41.0370$, $DS = 12.38679$) dhe atyre të meshkujve ($M = 37.5000$, $DS = 8.36721$), $t(93.538) = -1.717$, $p < 0.05$.

Kapitulli IV

Ky kapitull përfshin rezultatet e dalura në këtë studim dhe krahasimin me rezultate të studimeve të ndryshme të cilat janë bërë në kontekste të ndryshme.

Diskutim : Tani më pothuajse në çdo studim është parë se rezilienca me të vërtetë po luan një rol negativ në poliviktimizimin dhe kjo tregon se rezistenca mund të mbrojë një individ nga zhvillimi i shëndetit të dobët mendor, veçanërisht në mesin e të rinjve që janë viktime të traumave të shumta. Mirëpo, edhe pse studimi ynë refuzoi disa nga hipotezat tona, nuk do të thotë që një fenomen i tillë nuk është i pranishëm në shoqërinë tonë kosovare e në shkollat tona